

Udhëzues për krijimin dhe mirë- funksionimin e Qeverisë së Nxënësve

*Hartuar në mbështetje të Programit të MASH-it 'Braktisja zero' 2009-2013 dhe në
kuadrin e Programit të Arsimit Bazë të UNICEF-it 2011-2012*

Punoi

Erlira Koci

Mbështetur nga UNICEF

Tiranë, 2012

Ky udhëzues është përgatitur në kuadrin e Programit të Arsimit Bazë të UNICEF-it (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët) 2011-2012. Projekti ka pasur në fokus çështje të reformimit të Qeverive të Nxënësve dhe titullohet: ‘Aktivizohuni nëse doni që zëri juaj të dëgjohej dhe vota juaj të numërohet’. Ai është zbatuar në shkollat e arsimit bazë të qarkut të Kukësit, Durrësit, Beratit, Gjirokastrës dhe Korçës nga Shoqata ‘Alb-Aid’ gjatë periudhës 2011-2012.

Grupi i projektit

MASH

Fatmir Vejsiu

Rozalba Merdani

Ndriçim Mehmeti

Stafi i Shoqatës ‘Alb-Aid’

Nën kujdesin e përgjegjëses së

Programit të Arsimit Bazë, UNICEF

Aurora (Karaxha) Bushati

Mbështetur nga UNICEF

Rruga ‘Skënderbej’, Godina e Volkswagen-it, Kati i 3-të.

Tiranë, Shqipëri.

Tel: (+335-4) 2 273 335

Fax: (+335-4) 2 243 775

<http://www.unicef.org/albania>

Përmbajtja

Kreu 1

QEVERIA E NXËNËSVE, ÇFARË ËSHTË DHE SI VEPRON

Çfarë është Qeveria e nxënësve

E drejta e nxënësve të një shkolle për të formuar qeverinë e tyre

Dobia e Qeverisë së nxënësve

Roli i Qeverisë së nxënësve

Objekti i punës së Qeverisë së nxënësve

Marrëdhëniet brenda shkollës

Qeveria e nxënësve dhe nxënësit e tjerë të shkollës

Qeveria e nxënësve dhe Drejtori i shkollës

Qeveria e nxënësve dhe Bordi i shkollës

Qeveria e nxënësve dhe mësuesi ndihmues

Qeveria e nxënësve dhe mësuesit e shkollës

Qeveria e nxënësve dhe prindërit

Qeveria e nxënësve dhe struktura të tjera jashtë shkollës

Kreu 2

HAPAT PËR KRIJIMIN E QEVERISË SË NXËNËSVE

Sensibilizimi

Krijimi i Qeverisë së nxënësve

Para zgjedhjeve

Përgatitja për zgjedhjet dhe zhvillimi i zgjedhjeve

Pak fjalë për fushatën

Kreu 3

ECURIA E PUNËS

Ku mbështetet

Si organizohet puna

Komunikimi

Planifikimi dhe vlerësimi i punës

Sigurimi i fondeve

Shpërndarja e Qeverisë së nxënësve

Lirimi dhe zëvendësimi i një anëtari ose disa anëtarëve

Aneks 1

Aneks 2

Aneks 3;

Aneks 4

KREU 1

QEVERIA E NXËNËSVE, ÇFARË ËSHTË DHE SI VEPRON

Çfarë është Qeveria e nxënësve

Qeveria e nxënësve është **një grup nxënësish të një shkolle**, të zgjedhur me votim nga nxënësit e asaj shkolle për t'i përfaqësuar ata dhe pikëpamjet e tyre.

Qeveria e nxënësve është një formë organizimi e nxënësve për ushtrimin e të drejtës dhe përgjegjësi të tyre pjesëmarrëse në vendimmarrje të rëndësishme të shkollës dhe jashtë saj.

Qeveria e nxënësve, megjithëse përbëhet nga një grup nxënësish, në të vërtetë është **zëdhënëse e interesave të komunitetit të nxënësve për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të kontribuar në plotësimin e nevojave dhe zhvillimin e interesave të tyre** duke synuar një shërbim arsimor sa më cilësor.

Nëpërmjet qeverisë së tyre, **qeverisin të gjithë nxënësit e shkollës**. Ata përfshihen në zgjidhjen e problemeve të shkollës, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, stafin dhe prindërit, në të mirë të shkollës dhe të vetë nxënësve.

Funksionimi i Qeverisë së nxënësve krijon një **mentalitet të ri për pozicionin dhe rolin e nxënësve në shkollë**, duke i parë ata si partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Qeveria e nxënësve **bashkëvepron** me organet kolegjiale të shkollës.

E drejta e nxënësve të një shkolle për të formuar qeverinë e tyre

Krijimi i Qeverisë së nxënësve është një model konkret për zbatimin e “Konventës për të drejtat e fëmijëve” dhe një sërë dokumentesh të tjera që kanë të bëjnë me lirinë dhe të drejtat e individit. “Konventa për të drejtat e fëmijëve” ratifikuar nga Qeveria Shqiptare u jep fëmijëve dhe të rinjve një sërë të drejtash ku ndërmjet të tjerash theksohet:

“Fëmija ka të drejtë të thotë lirisht mendimin e tij në çështjet që lidhen me të.” (Neni 12)

Ligji për arsimin parauniversitar dhe Dispozitat Normative, me anë të neneve të posaçme, mundësojnë krijimin e Qeverisë së nxënësve mbi bazën e nismës së lirë nga ana e tyre. Në këto

dokumente përshkruhen edhe parimet e kriteret bazë të përgjithshme të funksionimit të Qeverisë së nxënësve. Ajo krijohet dhe funksionon në përputhje me të gjitha udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës që kanë lidhje me të dhe me rregulloren e brendshme të shkollës.

Dobia e Qeverisë së nxënësve

Krijimi dhe funksionimi me efikasitet i Qeverisë së nxënësve ndikon pozitivisht në jetën e shkollës sepse:

- krijohet një **partneritet i strukturuar** me nxënës, drejtues, mësues, prindër në dobi të mirës së përbashkët. Realizimi i objektivave të shkollës është i suksesshëm kur ato kuptohen qartë dhe pranohen nga të gjithë partnerët brenda komunitetit të shkollës;
- **informohen** edhe nxënësit për ecurinë e punës së shkollës
- nxënësit mund të **tregojnë që janë të aftë të japin një kontribut të vlefshëm** për të rritur cilësinë e shkollës së tyre
- nxënësve u jepet mundësia të **dëgjoen** nga të gjithë partnerët e shkollës, për të paraqitur shqetësime, ide dhe sugjerime që kanë të bëjnë me mirëqenien e tyre dhe mbarëvajtjen e shkollës
- sigurohet **pjesëmarrja e të rinjve nëpërmjet një rruge konkrete**. Qeveria e nxënësve është si një laborator në të cilin nxënësit mund të nxënë dhe të praktikojnë shprehitë e qytetarisë, respektin për dinjitetin njerëzor dhe zbatimin e proceseve demokratike
- nxënësve u rritet **personaliteti, u forcohet ndjenja e iniciativës dhe sipërmarrjes** të cilat janë të nevojshme për individin e shoqërisë së sotme
- nxënësve u jepet mundësia të fitojnë dhe të zhvillojnë më tej **shprehi të komunikimit, punës në grup, planifikimit, bashkërendimit, organizimit dhe drejtimit** të cilat do t'u vlejnjë edhe për të ardhmen
- sigurohet një **burim i vlefshëm informacioni** për drejtuesit e shkollës dhe drejtues të tjerë të arsimit jashtë shkollës, mësuesit dhe nxënësit e tjerë të shkollës për çështje që i preokupojnë të gjithë
- krijohet **atmosferë pozitive** në shkollë

Roli i Qeverisë së nxënësve

Shkolla është një mini-shoqëri që ka rregullat, normat dhe vlerat e saj. Shkolla modelon një mënyrë të jetuari dhe të vepruari dhe është si një arenë në të cilën përvojat që merren zgjasin për gjithë jetën. Një nga synimet e arsimit është të përgatisë njerëz që të jenë qytetarë aktivë dhe të mirinformuar për komunitetet në të cilat jetojnë; të kuptojnë ndryshimin dhe të bëhen pjesë e ndryshimit. Një nga risitë e shkollës për këtë qëllim është edhe Qeveria e nxënësve, e cila duke qenë një nga format e demokracisë në veprim, luan rol parësor në edukimin e vlerave e

qëndrimeve demokratike dhe i ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe të binden se edhe ata mund të jenë aktorë të ndryshimit, në shkollë, në komunitet dhe më gjerë në shoqëri.

Qeveria e nxënësve është e suksesshme në rolin e saj nëse:

- **dëgjon** pikëpamjet, sugjerimet e idetë e të gjithë nxënësve të shkollës
- **mbro** të drejtat e nxënësve
- **përfaqëson** pikëpamjet e nxënësve duke u kthyer në një forum ku të gjithë nxënësit mund të adresohen për çështjet me interes të përgjithshëm për ta
- **është partnere ose lehtësuese** në punën për arritjen e objektivave të shkollës
- **sensibilizon dhe këshillon** masën e nxënësve për zbatimin e politikave të reja në shkollë
- **është nismëtare dhe nxitëse** e ideve në të mirë të shkollës, të vetë nxënësve dhe të komunitetit më të gjerë
- **informon** drejtuesit e shkollës lidhur me shqetësimet e nxënësve për të cilat ata nuk janë në dijeni dhe për zgjidhjet që propozon
- **vendos ura komunikimi** ndërmjet nxënësve nga njëra anë dhe mësuesve, drejtuesve, prindërve e komunitetit nga ana tjetër (Qeveria e nxënësve jo vetëm informon drejtuesit e shkollës për shqetësimet dhe propozimet e nxënësve, por edhe nxënësit për qëndrimin dhe reagimin e drejtuesve të shkollës)
- **ndihmon në formën e patronazhit**, nxënës me probleme (personale, sociale etj)
- **motivon krijimin e një klime pozitive** në shkollë duke ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve dhe organizimin e veprimtarive me tematika interesante e gjithëpërfshirëse
- **bashkëpunon** me komunitetin e gjerë
- **ndikon në përmirësimin e marrëdhënieve nxënës–nxënës** duke nxitur miqësinë dhe respektin midis tyre
- **ndikon në përmirësimin e marrëdhënieve mësues- nxënës**
- **Ndikon në përmirësimin e kushteve të mjedisit** mësimor dhe mjedisit fizik të shkollës

Qeveria e nxënësve përcjell zërin e nxënësve në strukturat e tjera të shkollës dhe nëse është e nevojshme edhe jashtë saj për plotësimin e interesave të komunitetit të nxënësve për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për një arsimim sa më cilësor.

Objekti i punës së Qeverisë së nxënësve

Objekti i punës së Qeverisë së nxënësve përbëhet nga veprimtari të cilat përmbushin rolin e saj. Veprimtaritë duhet të jenë në koherencë me legjislacionin aktual për arsimin parauniversitar, udhëzimet e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për funksionimin e shkollës, kurrikulat, rregulloren e brendshme të shkollës dhe planet e punës.

Qeveria e nxënësve mund të hartojë e të zbatojë, në marrëveshje me drejtuesit e shkollës, projekte që janë në interes të përmbushjes së objektivave të shkollës dhe të rritjes së mirëqenies së nxënësve të saj.

Në planifikimin dhe kryerjen e veprimtarive përgjatë vitit shkollor, bashkëpunon ngushtë me drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe prindërit; konsultohet rregullisht me nxënësit e tjerë të shkollës dhe përfshin sa më shumë nxënës në veprimtaritë e organizuara.

Qeveria e nxënësve planifikon dhe realizon një gamë të gjerë veprimtarish disa prej të cilave janë paraqitur në vijim:

- **Veprimtari që kanë të bëjnë me përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të nxënësve** te drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale. Këtu përfshihen si veprimtari që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit nga nxënësit (me anë të bisedave, vëzhgimeve, pyetësorëve etj.) ashtu edhe veprimtari që kanë të bëjnë me paraqitjen e informacionit te drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale dhe diskutimin me ta.
- **Veprimtari që nxitin një komunikim më të mirë brenda në shkollë**
Përmirësimi i komunikimit brenda komunitetit të shkollës është një përgjegjësi e përbashkët dhe Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë në këtë proces duke ndërtuar ura komunikimi me nxënësit e shkollës, drejtuesit e shkollës, stafin, dhe prindërit. Këtu përfshihen prezantimi para mësuesve dhe këshillit të prindërve i veprimtarive të kryera, nxjerrja e një gazete etj.
- **Veprimtari për të ndihmuar nxënësit e tjerë për përparimin e tyre**
Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë duke propozuar metoda konkrete në funksion të përparimit të nxënësve. Përshtetull për të ndihmuar nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të ndihmuar integrimin e nxënësve që fillojnë për herë të parë shkollën ose një nivel shkollimi (p.sh. klasën e 10 në rastin e gjimnazeve) etj.
- **Veprimtari që ndihmojnë mbarëvajtjen e shkollës**
Qeveria e nxënësve mund të japë ndihmesë në mënyrë aktive në mbarëvajtjen e shkollës duke formuar grupe të përkohshme pune me nxënës për një çështje të posaçme (përshtetull për disiplinën, për mjedisin etj.) dhe të paraqesë te drejtuesit propozime konkrete. Qeveria e nxënësve mund të propozojë edhe veprimtari jashtëkurrikulare (p.sh. organizimin e konkurseve).
- **Veprimtari që lidhen me ngjarje shkollore sportive dhe kulturore**
Qeveria e nxënësve mund të ndihmojë në organizimin dhe zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve kulturore në shkollë.
- **Veprimtari që lidhen me ndihmesën ose me organizimin e përfutimit të fondeve për bamirësi**
Qeveria e nxënësve mund të organizojë veprimtari si brenda shkollës dhe jashtë shkollës (p.sh. sensibilizimin për një problem që kërkon fonde, shfaqje artistike) me përfshirjen e komunitetit më të gjerë, me qëllim përfutimin e fondeve për bamirësi të caktuara.

- **Veprimtari që sigurojnë komunikimin me qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera**

Është e dobishme që Qeveria e nxënësve të një shkolle të bashkëpunojë me Qeveritë e Nxënësve të shkollave të tjera (p.sh. veprimtari të përbashkëta artistike, sportive, projekte të përbashkëta). Në këtë këndvështrim një vlerë të veçantë do të kishte bashkëpunimi me një qeveri nxënësish të formuar rishtazi në favor të kësaj të fundit.

Për realizimin e planeve të saj, Qeveria e nxënësve mund të ndërtojë ura komunikimi e bashkëpunimi me të gjitha organet drejtuese të arsimit në shkollë e më gjerë dhe strukturat kolegjiale të shkollës

Qeveria e nxënësve bashkëpunon për probleme e projekte të caktuara me organizata jashtë shkollës, të cilat kanë në fokus të punës së tyre të drejtat e njeriut dhe arsimin.

Marrëdhëniet brenda shkollës

Formimi dhe funksionimi i Qeverisë së nxënësve u ofron të gjithë të interesuarve mundësi për bashkëpunim dhe komunikim efektiv brenda shkollës.

Qeveria e nxënësve dhe nxënësit e shkollës

Një nga mënyrat me të cilën nxënësit e shkollës komunikojnë me qeverinë e tyre është ajo informale, nëpërmjet bisedave të lira.

Kryesia e Qeverisë së nxënësve duhet të planifikojë edhe mënyra të tjera formale për t'u informuar për interesat, dëshirat, problemet dhe sugjerimet e nxënësve të shkollës përshembull:

- të caktojë një orar në mjedisin e saj të punës për takime me nxënësit
- të zhvillojë biseda të organizuara me nxënës të një klase edhe thjesht për të informuar për punën e kryer
- të kryejë pyetësorëve apo intervista për një temë të caktuar
- të qarkullojë planin mujor të veprimtarive për të marrë reagime nga nxënësit
- të vendosë diku në shkollë një kuti ku nxënësit mund të futin ide e sugjerime

Sa më e shpeshtë të jetë përfshirja e masës së nxënësve në punën e qeverisë së tyre aq më tepër perfeksionohet profili i saj.

Organizimi i veprimtarive të ndryshme nga Qeveria e nxënësve duhet të reflektojë interesat e tyre moshore dhe jo të diktohet nga strukturat drejtuese të shkollës.

Qeveria e nxënësve dhe Drejtori i shkollës

Në detyrat e Drejtorit të shkollës të përcaktuara me ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” vihet re qartë që Drejtori i shkollës është vendosur në qendër të gjitha veprimtarive të shkollës. Si i tillë ai ka një rol të rëndësishëm si në themelimin e Qeverisë së nxënësve ashtu edhe në funksionimin e saj.

Drejtori i shkollës është i interesuar dhe ka përgjegjësinë e detyrës që i është ngarkuar që nëse Qeveria e nxënësve formohet, ajo të veprojë konform legjislacionit dhe të jetë sa më efiçente. Si rrjedhojë roli i Drejtorit të shkollës është i dyfishtë; nga njëra anë si bashkëpunues dhe udhërrëfyes i vazhdueshëm dhe nga ana tjetër si monitorues i procesit të formimit dhe funksionimit për të siguruar që formimi dhe veprimtaria e Qeverisë së nxënësve nuk bien ndesh me legjislacionin e posaçëm dhe legjislacionin e rregullorën e shkollës dhe është në dobi të shkollës në tërësi.

Fokusi i marrëdhënieve me drejtorin e shkollës ndryshon përgjatë procesit.

Faza e sensibilizimit dhe e themelimit

Drejtori i shkollës së bashku me mësuesit mund të inkurajojë formimin e Qeverisë së nxënësve duke ju servirur botime që përshkruajnë përvoja pozitive dhe ku dalin në pah përfitimet për të gjithë partnerët e shkollës.

Në fazën fillestare, kur nxënësit kanë shprehur dëshirën për të formuar qeverinë e tyre, Drejtori, së bashku me mësuesit e tjerë, mund të ndihmojë në themelimin e Qeverisë së nxënësve duke u siguruar nxënësve të gjithë informacionin e nevojshëm që ka të bëjë me legjislacionin (Ligji për Arsimin Parauniversitar, Dispozitat Normative dhe akte nënligjore, udhëzime dhe urdhra të posaçme të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës) dhe t’i ndihmojë me biseda dhe diskutime në mënyrë që ata t’i kuptojnë sa më mirë.

Më tej, Drejtori i shkollës menaxhon hartimin e një plani veprimi pune që përfshin edhe fazën e zgjedhjeve deri në formimin e Qeverisë së nxënësve.

Drejtori lehtëson kryerjen e zgjedhjeve dhe i monitoron ato (p.sh. duke caktuar një mësues) që të zhvillohen konform rregullave dhe me transparencë.

Faza e funksionimit

Qeveria e nxënësve ka nevojë për një mjedis pune caktimi i të cilit është detyrë dhe kompetencë e Drejtorit të shkollës.

Ndërkohë që Qeveria e nxënësve fillon të ushtrojë funksionin e saj, shtohet edhe përgjegjësia e dyanshme ndërmjet Drejtorit të shkollës dhe Qeverisë së nxënësve për vendosjen e marrëdhënieve reciproke në përputhje me rregullorën e shkollës dhe rregullorën e Qeverisë së nxënësve ku janë të përcaktuara detyrat dhe të drejtat e secilit .

Nga njëra anë Drejtori duhet të jetë i gatshëm të këshillohet me kryesinë e Qeverisë së nxënësve, të dëgjojë, të reflektojë dhe të përfshijë Qeverinë e nxënësve për çështje të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e nxënësit.

Nga ana tjetër Qeveria e nxënësve, për një sërë problemesh duhet të ndjejë nevojën për këshillim me Drejtorin dhe për një sërë të tjerash të presë miratimin e Drejtorit sipas kriterëve të parashikuara në rregullore.

Bashkëpunimi me Drejtorin e shkollës është i frytshëm nëse ai ka bindjen për efektin e fuqishëm dhe të vlefshëm që një Qeveri nxënësish mund të bëjë në zhvillimin e shkollës dhe nëse Qeveria e nxënësve e njeh autoritetin e Drejtorit dhe kërkon mbështetje të ai sa herë ta ndjejë të nevojshme.

Qeveria e nxënësve dhe Bordi i shkollës

Në Bordin e shkollës bëjnë pjesë një ose më shumë përfaqësues të Qeverisë së nxënësve, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin përkatës. Kryetari i Qeverisë së nxënësve merr pjesë edhe në disa prej komisioneve të formuara nga Bordi i shkollës.

Në funksionet e Bordit të shkollës të përcaktuara me ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, vihet re qartë që veprimtaria e Bordit të shkollës krijon hapësira për një bashkëpunim me Qeverinë e nxënësve në të mirë të dy palëve. Bashkëpunimi realizohet me forma e mënyra të ndryshme:

- Kryetari ose përfaqësues të qeverive të nxënësve duhet të jenë **të pranishëm në mënyrë aktive në Bordin e shkollës me statusin e anëtarit të përhershëm**. Është detyra e të zgjedhurve të respektojnë mandatin e fituar me vota në shkollat e tyre, duke përcjellë me kurajo dhe argumente shqetësimet dhe problematikat e nxënësve të shkollës ku ata bëjnë pjesë.
- Anëtarë të Bordit të shkollës mund të **ftohen herë pas here të marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë së nxënësve**
- **Kryetari i Qeverisë së nxënësve ose përfaqësues të saj duhet të prezantojnë herë pas here, para Bordit, punën e kryer**. Për projekte të cilat ndërmerren në bazë shkolle Qeveria e nxënësve duhet të bashkëpunojë me Bordin në ato raste kur tematika përfshihet në funksionet e Bordit.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh që **Bordi i shkollës** jo vetëm të dëgjojë përfaqësuesit e Qeverisë së nxënësve, por edhe **t'i përgjigjet konkretisht shqetësimeve të saj**.

Qeveria e nxënësve dhe mësuesi ndihmues

Roli i mësuesit ndihmues në mbarëvajtjen e Qeverisë së nxënësve është shumë i rëndësishëm. Këtë rol mund ta kryejë një nga mësuesit e shkollës i cili caktohet të punojë pranë Qeverisë së nxënësve për të ndihmuar dhe këshilluar kryesisht në tri drejtime:

- në hartimin dhe zbatimin e planit të veprimtarive, përfshirë edhe menaxhimin e fondeve
- në funksionimin sa më të mirë të lidhjeve të Qeverisë së nxënësve me hallkat e tjera të shkollës
- në nxitjen e interesave dhe ideve

Përvojat e deritanishme, në vendin tonë dhe në vendet e tjera, tregojnë që, nëse është bërë zgjedhja e duhur, prania e një mësuesi pranë Qeverisë së nxënësve është faktor pozitiv në mbarëvajtjen e saj.

Mësuesi ndihmues zgjidhet me konsensus ndërmjet kryetarit të Qeverisë së nxënësve dhe Drejtorit të shkollës.

Në caktimin e mësuesit ndihmues është mirë të mbahen parasysh disa kritere si p.sh.:

- mësuesi koordinator mund të jetë anëtar i Bordit të shkollës, por jo anëtar i Drejtorisë
- është e arsyeshme të zgjidhet ai mësues që është i trajnuar (nëse ka të tillë) posaçërisht
- duhet të pëlqehet nga nxënësit dhe të ketë dëshirë dhe vullnet për të punuar me ta
- të ketë fituar respektin e kolegëve
- të ketë aftësi organizuese, komunikuese dhe menaxhuese

Detyrat dhe të drejtat e mësuesit ndihmues ndaj Qeverisë së nxënësve përcaktohen me marrëveshje nga Drejtori i shkollës dhe Kryetari i Qeverisë dhe specifikohen në rregulloren e brendshme të Qeverisë së nxënësve.

Detyrat kryesore të mësuesit ndihmues janë:

- ndihmon në sigurimin dhe forcimin e rolit të Qeverisë së nxënësve në shkollë
- ndjek mbledhjet e Qeverisë së nxënësve dhe këshillon, jep informacion dhe moderon situata të caktuara nëse kjo gjë i kërkohet
- kujdeset që Qeveria e nxënësve të veprojë brenda kompetencave të saj
- ofron trajnim për çështje të veçanta
- ndihmon për komunikimin e ndërsjellë me drejtuesit e shkollës
- ndihmon në vendosjen e lidhjeve me këshillin e mësuesve duke ndikuar që çështjet e Qeverisë së nxënësve të parashikohen në mbledhjet e radhës
- inkurajon mësuesit dhe anëtarë e Qeverisë së nxënësve të ftojnë njëri tjetrin në mbledhjet e tyre
- ndihmon që Qeveria e nxënësve të bëhet pjesë aktive e jetës së shkollës
- ndjek me vëmendje ecurinë e punës së Qeverisë së nxënësve në mënyrë që të jetë i përgatitur për të ofruar ndihmë në çdo moment që i kërkohet

- kujdeset që të gjithë anëtarëve të Qeverisë së nxënësve tu jepet rasti për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe asnjë të mos anashkalohet apo favorizohet
- mësuesi ndihmues mund të luajë rolin e ndërmjetësit kur ka mosmarrëveshje

Ka njëfarë dallimi ndërmjet rolit të mësuesit ndihmues në qeverinë e shkollës së mesme dhe rolit të mësuesit ndihmues në qeverinë e shkollës 9-vjeçare. Në shkollën 9-vjeçare, për shkak të moshës së nxënësve, mbikëqyrja dhe monitorimi zënë më tepër vend, veçanërisht për disa aspekte të punës së Qeverisë së nxënësve.

Qeveria e nxënësve dhe mësuesit e shkollës

Krijimi një fryme partneriteti dhe bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë së nxënësve dhe mësuesve është dobiprurëse për të dy palët.

Qeveria e nxënësve mund të luajë një rol të rëndësishëm në evidentimin dhe mbështetjen e punës së mësuesve.

Interesimi dhe mbështetja e mësuesve është me vlerë të madhe për një Qeveri nxënësish, veçanërisht në fazat e hershme të punës së saj.

Është e dëshirueshme që një mësues (përveç mësuesit ndihmues) të marrë pjesë në mbledhje të Qeverisë së nxënësve. Mbështetja dhe udhëzimet e ofruara nga një mësues janë shumë të dobishme për një Qeveri nxënësish kur planifikon apo organizon veprimtaritë (p.sh. për organizimin e një veprimtarie sportive mund t'i kërkohet mendim mësuesit të edukimit fizik).

Nga ana tjetër anëtarë të Qeverisë së nxënësve është e dëshirueshme të ftohen në mbledhje të personelit mësimor në rastet kur tematika përshtatet me funksionet ose me veprimtarinë aktuale të Qeverisë së nxënësve.

Qeveria e nxënësve komunikon edhe me psikologun e shkollës, me drejtorin e konviktit në rastin e shkollave me konvikt, për t'u konsultuar për probleme zgjidhja e të cilave kërkon informacion dhe këshillim prej tyre. Edhe psikologu apo drejtori e personeli i konvikteve do ta kenë më të lehtë përballjen me një sërë situatash nëse bashkëpunojnë me Qeverinë e nxënësve.

Qeveria e nxënësve dhe prindërit

Prindërit, nëpërmjet Këshillit të prindërve, por edhe individualisht, mund të japin një ndihmesë me vlerë në ecurinë e punës së Qeverisë së nxënësve.

Përfaqësues të prindërve mund të marrin pjesë here pas here në mbledhjet ose veprimtaritë e Qeverisë së nxënësve për të qenë të mirinformuar.

Përfaqësues të Qeverisë së nxënësve mund të paraqesin para Këshillit të prindërve projekte apo veprimtari që kanë planifikuar për të marrë një mendim nga ata.

Këshilli i prindërve mund të jetë një nga burimet për sigurimin e fondeve.

Qeveria e nxënësve dhe struktura të tjera jashtë shkollës

Qeveria e nxënësve , me miratimin e Drejtorit, bashkëpunon për projekte të përbashkëta edhe **me organizata jofitimprurëse** të cilat kanë në fokusin e tyre të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje dhe arsimin.

Në këtë aspekt, është rëndësishme që idetë dhe propozimet e Qeverisë së nxënësve në bashkëpunim me mësuesin ndihmues, mësues të tjerë dhe psikologun e shkollës, të paraqiten si projekte.

Qeveria e nxënësve të një shkolle vendos ura bashkëpunimi, përfshirë edhe atë elektronike, **me qeveri të shkollave të tjera** brenda ose jashtë vendit me qëllim shkëmbim përvojë ose ndërmarrjen e projekteve të përbashkëta.

Qeveria e nxënësve komunikon edhe me DAR/ZA. Një specialist i DAR/ZA caktohet për të ndjekur dhe ndihmuar Qeverinë e nxënësve në shkollat në juridiksion, me qëllim përmbushjen sa të mirë të misionit të tyre.

Për këtë qëllim, specialisti organizon shkëmbimin e përvojave më të mira në mes Qeverive të nxënësve dhe mësuesve që i ndihmojnë ato.

KREU 2

HAPAT PËR KRIJIMIN E QEVERISË SË NXËNËSVE

Sensibilizimi

Qeveria e nxënësve të një shkolle ngrihet me nismën e nxënësve të shkollës.

Nëse nxënësit e një shkolle nuk e kanë marrë akoma nismën për të formuar Qeverinë e tyre, është e dëshirueshme që drejtuesit dhe mësuesit të shkollës të nxitin themelimin e saj nëpërmjet sensibilizimit të nxënësve, me anë të bisedave, botimeve informuese të përshtatshme për moshën e tyre, organizimit të takimeve me Qeveri Nxënësish tashmë të ngritura me qëllim që, nëpërmjet përvojave të ndryshme, të njihen me dobinë e funksionimit të Qeverisë së nxënësve.

Takimet ndërmjet shkollave mund të organizohen edhe nga specialisti i DAR/ZA i ngarkuar për mbikëqyrjen dhe ndihmesën për Qeveritë e Nxënësve.

Më pas nxënësit lihen të lirë të vendosin vetë, nëse duan ose jo, të kenë Qeverinë e tyre.

Krijimi i Qeverisë së nxënësve

Se cilët e formojnë Qeverinë e nxënësve dhe mënyra se si formohet janë dy faktorë të rëndësishëm për funksionimin me sukses të saj, për angazhimin e anëtarëve, për komunikimin me të gjitha hallkat dhe për mënyrën se si konceptohet e përkrahet nga nxënësit dhe stafi i shkollës.

Krijimi i Qeverisë së nxënësve kërkon kohën e duhur, nuk mund të ndodhë gjithçka brenda një jave.

Rëndësia që i jepet procesit reflekton rëndësinë që shkolla i jep Qeverisë së nxënësve. Sa më shumë të punohet në fazën e krijimit aq më seriozisht do të kryhen votimet. Sa më shumë nxënës të përfshihen aq më frytdhënës do të jetë bashkëpunimi në të ardhmen.

Drejtori i shkollës dhe mësuesit duhet të preokupohen për të venë në dispozicion të gjithë informacionin e përshtatshëm duke shfrytëzuar sa më shumë burime dhe metoda.

Nxënësit që kanë marrë pjesë në Qeverinë e mëparshme janë një burim i mirë dhe i besueshëm informacioni. Ata mund të flasin për përvojën, opinionin e tyre dhe të bëjnë sugjerime të reja.

Mund të përdoret edhe rrjeti elektronik brenda shkollës për të informuar ecurinë dhe rregullat e proceseve. E rëndësishme është që gjithkush të mund të marrë informacionin që i duhet si

përshembull: si do të veprohet, cilët janë kandidatët, ku do të votohet, si do të votohet, kur do të votohet etj.

Po aq të rëndësishme janë edhe respektimi i kërkesave standarde për të gjitha shkollat, mënyra e organizimit të zgjedhjeve, numri i të zgjedhurve dhe përfaqësimi.

Formimi i Qeverisë së Nxënësve, veçanërisht kur formohet për herë të parë, kërkon kohën e duhur për të mirinformuar të gjithë nxënësit e shkollës dhe stafin për secilën nga fazat e procesit.

Një nga dobitë e procesit të formimit të Qeverisë së nxënësve është edukimi i zgjedhësit, votuesit dhe përgatitja e qeveritarit të ardhshëm.

Para zgjedhjeve

Puna për krijimin e Qeverisë së nxënësve fillon nëse një grupi nxënësish të shkollës u lind ideja e formimit të qeverisë së tyre. Megjithatë, nuk mjafton që dëshirën ta kenë vetëm një grup i vogël nxënësish. Ata duhet të bisedojnë edhe me nxënës të tjerë të shkollës në mënyrë që të kenë miratimin e një numri të mjaftueshëm (ky numër përcaktohet në rregulloren e brendshme të Qeverisë së nxënësve) nxënësish për të filluar procedurat e krijimit.

Pasi të jetë formuar numri i mjaftueshëm i nxënësve, disa përfaqësues të tyre paraqesin idenë te Drejtori i shkollës.

Drejtori i shkollës dhe mësuesit duhet ta mbështetin menjëherë nismën e nxënësve duke i ndihmuar konkretisht me sqarimet e nevojshme me gojë ose me shkrim. Drejtori i shkollës mund të caktojë 1-2 mësues të cilët do të ndihmojnë krijimin e Qeverisë së nxënësve.

Nëse shkolla ka pasur Qeveri Nxënësish, është në të mirë të punës që së bashku me mësuesit të angazhohen në krijimin e qeverisë së re edhe 2-3 nxënës që kanë qenë anëtarë të qeverisë së mëparshme. Ata do të sjellin përvojën e tyre, madje edhe të korrigjuar në të mirë të punës. Në mungesë të tyre caktohen disa nxënës vullnetarë, më të informuar se të tjerët. Në këtë mënyrë krijohet një grup pune i përkohshëm për formimin e Qeverisë së nxënësve.

Mësuesit ndihmues së bashku me një grup përfaqësues nxënësish prezantojnë dhe shpjegojnë, në secilën nga klasat e shkollës, rolin dhe funksionimin e Qeverisë së nxënësve.

Nëse nuk është hera e parë që po formohet Qeveria e nxënësve në shkollën e tyre, informacioni i nevojshëm mund të sigurohet edhe nga rregullorja e qeverisë së mëparshme, kombinuar me diskutime me anëtarë të qeverisë së mëparshme. Rregullores mund t'i bëhet ndonjë korrigjim për ta përshtatur më mirë me kushtet aktuale të shkollës për hapat e para të formimit të Qeverisë së nxënësve.

Leximi i rregullores apo i materialeve të tjera, madje edhe sqarimi i tyre nga ana e mësuesve, nuk mjafton që nxënësit të jenë të qartë se çfarë duhet të bëjnë. Puna për krijimin e Qeverisë së nxënësve është një projekt dhe si i tillë duhet hartuar me kujdes duke parashikuar kriteret dhe të gjitha veprimtaritë hap pas hapi, deri në momentin e shpalljes së zgjedhjeve dhe formimit të Qeverisë së nxënësve.

Drejtori i shkollës ndihmon grupin e punës, të cilët studiojnë me kujdes legjislacionin në fuqi, rregulloren e shkollës dhe udhëzimet e MASH e të DAR/ZA për krijimin e Qeverisë së nxënësve dhe hartojnë rregullat dhe veprimtaritë në formën e një plani pune për formimin e Qeverisë së nxënësve, ku do të përcaktohen:

- koha e nevojshme për informimin e nxënësve dhe mësuesve për vendimin për krijimin e Qeverisë së nxënësve, për funksionimin e saj dhe për detyrat e një anëtari të qeverisë; (çdo nxënës duhet të jetë i mirinformuar për detyrat që e presin para se të marrë vendimin nëse do të kandidojë ose jo)
- kriteret të përgjithshme për kandidatët
- kriteret për barazinë gjinore
- pozicionet për të cilat do të votohet
- përshkrimi në përgjithësi i detyrave të një pozicioni
- numri i të zgjedhurve gjithsej dhe për klasë
- organizimi dhe rregullat e fushatës
- data e zgjedhjeve
- vendi ku do të zhvillohen zgjedhjet
- rregullat për zgjedhjet, mënyra e votimit dhe e numërimit të votave
- veprimtaritë hap pas hapi së bashku me afatet kohore
- materiale pune të domosdoshme dhe mënyra e sigurimit të tyre

Disa prej tyre mund të jenë të përshkruara në udhëzimet e gatshme, për disa të tjera është lënë hapësirë që shkolla të vendosë sipas specifikave të saj (p.sh. numri të zgjedhurve për klasë, ndryshime të vogla në strukturën e qeverisë etj.).

Duhet bërë kujdes që veprimet që do të ndërmerren të mos bien ndesh me rregulloren e brendshme të shkollës, me legjislacionin në fuqi për arsimin dhe me planin e punës së shkollës. Për këtë arsye disa prej vendimeve kërkojnë miratimin e Drejtorit të shkollës (përshembull përcaktimi i datës së zgjedhjeve dhe i vendit ku do të zhvillohen zgjedhjet).

Në punën e mëvonshme shumica e materialeve të shkruara gjatë kësaj faze do të shërbejnë për të hartuar rregulloren e brendshme të Qeverisë së nxënësve.

Ato shkolla në të cilat ekziston rregullorja, e kanë më të lehtë sepse shumica e kritereve dhe normave janë të përcaktuara në rregullore. Në këtë rast mbetet për tu hartuar një plan veprimi i mirë detajuar.

Brenda mundësive të shkollës caktohet një mjedis për të punuar.

Zgjedhjet

Në procesin e përgatitjes për zgjedhjet dhe në procesin e zgjedhjeve është mirë të përfshihen sa më shumë nxënës dhe mësues. Edhe angazhimi i prindërve është i vlefshëm.

- Përfshirja e nxënësve i bën ata të kuptojnë që Qeveria e nxënësve po krijohet për ta dhe në të mirë të tyre.
- Përfshirja e mësuesve i bën ata të kuptojnë dhe pranojnë rolin e Qeverisë së nxënësve në shkollë.
- Përfshirja e prindërve i bën ata të ndihen të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shkollën.

Sa më seriozisht të mendohet dhe të kryhet procesi zgjedhor aq më i garantuar është sukcesi i mëtejshëm i punës së Qeverisë së nxënësve.

Procesi zgjedhor, nëse kryhet me transparencë dhe rigorozitet nuk ka vlerë vetëm për vetë Qeverinë e nxënësve, por edukon edhe vlera demokratike për qytetarin dhe votuesin e ardhshëm.

Drejtori i shkollës mund të ftojë ndonjë nga prindërit ose ndonjë dikë tjetër që ka përvojë në organizimin e zgjedhjeve për të rritur. Edhe bashkëpunimi me pushtetin vendor mund të sjellë përvoja dhe mund të sigurojë një pjesë të pajisjeve që duhen për zhvillimin e zgjedhjeve

Komisionet e zgjedhjeve

Krijohet **Komisioni i Zgjedhjeve të Klasës** që përbëhet nga mësuesi kujdestar dhe dy nxënës. Dy nxënësit, që zgjidhen me propozim dhe me votim nga nxënësit e klasës, nuk do të bëjnë pjesë në listën e kandidatëve.

Krijohet **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, i cili përbëhet nga dy mësues dhe disa nxënës, përfaqësues për çdo paralele të shkollës. Nxënësit që janë anëtarë të komisionit, nuk do të bëjnë pjesë në listën e kandidatëve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përveç detyrës lidhur me votimet, miraton edhe disa nga rregullat procedurale për zhvillimin e zgjedhjeve.

Caktimi i datës së zgjedhjeve



Koha më e përshtatshme për zgjedhjet është fillimi i vitit shkollor. Në këtë periudhë është e vërtetë që mësuesit janë të ngarkuar, por nxënësit janë më të çliruar nga presioni i mësimeve që vjen duke u shtuar gjatë vitit dhe kanë më tepër mundësi të ndihmojnë në organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve. Ka edhe një variant tjetër, sipas të cilit zgjedhjet të mbahen në fund të vitit shkollor, por ky variant përjashton nxënësit e vitit të parë. Përfaqësimi i sa më shumë nxënësve i bën zgjedhjet më legjitime dhe nxjerr në pah që Qeveria e nxënësve është për nxënësit dhe përbëhet nga nxënësit. Gjithsesi, përgatitja, duke angazhuar edhe anëtarët e qeverisë ekzistuese, mund të fillojë që në muajin maj ose qershor për të vazhduar me zgjedhjet në shtator.

Data e zgjedhjeve caktohet nga Komisioni qendror i zgjedhjeve me miratimin e Drejtorisë së shkollës.

Numri i përfaqësuesve në Qeverinë e nxënësve dhe përfaqësimi

Numri i përfaqësuesve në Qeverinë e nxënësve varet nga numri i nxënësve të shkollës dhe numri i klasave. Në shkolla me numër të vogël paralelesh mund të zgjidhen edhe më shumë se një përfaqësues për klasë. Duhet bërë kujdes që numri të jetë aq sa të lejojë menaxhimin e qeverisë. Një numër i madh, megjithëse do të siguronte një përfaqësim më të mirë, do të sillte probleme në menaxhim.

Ka rëndësi të respektohet që Qeveria e nxënësve është përfaqësuese e të gjithë nxënësve, prandaj secila klasë duhet të ketë përfaqësuesin e vet.

Në shkollat 9-vjeçare mund të përjashtohen nga përfaqësimi klasat e ciklit të ulët ose disa prej tyre. Më tej, gjatë punës, duhet bërë kujdes të gjendet mënyra që të dëgjohet dhe të përfaqësohet edhe zëri i tyre.

Parimet e zgjedhjeve

Megjithëse procedura e zgjedhjeve mund të ketë ndryshime të vogla nga shkolla në shkollë, duhen respektuar disa parime bazë:

- në Qeverinë e nxënësve zgjidhen vetëm nxënësit
- për Qeverinë e nxënësve votojnë vetëm nxënësit
- një nxënës ka një votë
- për procedurat e zgjedhjeve është rënë dakord paraprakisht
- të gjithë nxënësit janë të mirëinformuar se si, kur, ku dhe për kë do të bëhet votimi

Kandidatët për përfaqësuesit e klasave të shkollës

Nga secila klasë zgjidhen përfaqësuesit/përfaqësuesi për Qeverinë e nxënësve.

“Qeveritari” që do të zgjidhet prej tyre duhet:

- të jetë i përkushtuar

- të jetë i besuar
- të jetë i ndershëm
- të dijë të organizojë
- të jetë bashkëpunues
- të jetë dëgjues i mire
- të shquhet për përpikmëri
- të përpiqet për të zgjidhur konfliktet
- të jetë i gatshëm të kryejë detyra që kanë lidhje me Qeverinë e nxënësve
- të ketë arritje mbi mesatare në të nxënë dhe shumë të mira në sjellje
- të ketë dëshirë të punojë për të mirën e klasës dhe të shkollës

Cilësitë e mësipërme mund të saktësohen ose mund t'u bashkëngjiten edhe kritere të tjera të vendosura nga shkolla.

Numri i të zgjedhurve është përcaktuar paraprakisht.

Për zgjedhjet në klasa një rol të rëndësishëm, si sqarues, këshillues dhe lehtësues, luan mësuesi kujdestar. Paraprakisht ai u sqaron nxënësve procedurën e zgjedhjeve, fletën e votimit, dhe mënyrën e votimit.

Nxënësit duhet ta kenë të qartë rolin e përfaqësuesit të klasës që ata të marrin një vendim sa më të pjekur qoftë si zgjedhës qoftë si i zgjedhur.

Anëtari i Qeverisë së nxënësve, si përfaqësues një klase të shkollës:

- merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Qeverisë së nxënësve
- kryen detyrat që i ngarkohen nga kryetari
- përfaqëson pikëpamjet dhe idetë e klasës në Qeverinë e nxënësve
- këmbëngul që problemet e ngritura në klasën e tij të bëhen pjesë e tematikës së mbledhjeve të Qeverisë së nxënësve
- informon nxënësit e klasës së tij për diskutimet dhe konkluzionet e arritura në mbledhjen e Qeverisë së nxënësve
- kërkon mendimin dhe ndihmën e nxënësve të klasës për probleme të ndryshme
- ndikon pozitivisht në punën dhe në imazhin e Qeverisë së nxënësve
- punon paralelisht me anëtarët e tjerë dhe në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, mësuesit e organet kolegjiale të shkollës në të mirë të shkollës e të gjithë nxënësve

Zhvillimi i zgjedhjeve në klasa

Zgjedhjet në klasa zhvillohen sipas kësaj procedure zinxhir:

- Përpilohet lista e kandidatëve.

- Një nga mënyrat është që çdo kandidat të propozohet nga 2-5 nxënës të klasës. Emri i të propozuarit shkruhet në listë vetëm pasi i është marrë miratimi edhe atij vetë. Normalisht propozohen 5-6 kandidatë.
- Një mënyrë tjetër është që secili nxënës, me votim të fshehtë, shkruan emrin që propozon. Zgjidhen 5-6 të parët në renditje që kanë marrë më shumë vota.
- Secila shkollë vendos vetë për mënyrën e përpilimit të listës së kandidatëve, por në të gjitha klasat e një shkolle do të zbatohet e njëjta mënyrë votimi.
- Secili kandidat ka të drejtë që të bëjë fushatë elektorale për një periudhë kohe 3-4 ditë. Gjatë kësaj fushate ai duhet të tregojë idetë e tij dhe arsyet se përse shokët e klasës duhet të votojnë dhe ta zgjedhin pikërisht atë si përfaqësues të tyre.
- Komisioni zgjedhor i klasës shqyrton kandidaturat dhe miraton ato kandidatura që plotësojnë kriteret e paracaktuara.
- Kandidati për përfaqësues në qeveri paguan një kuotë të caktuar që derdhet në buxhetin e Qeverisë së nxënësve dhe është e pakthyeshme.
- Bëhen gati fletët e votimit, të përgatitura nga komisioni qendror i zgjedhjeve, me emrat e listës.
- Organizohet votimi i fshehtë. Secili nxënës do të votojë për kandidatin që preferon. Votimi monitorohet nga komisioni zgjedhor i klasës.
- Numërohen votat. Numërimi i votave kryhet nga Komisioni i Zgjedhjeve të Klasës dhe monitorohet nga dy-tre nxënës të klasave të tjera.
- Në monitorimin e votimeve dhe numërimin e votave mund të angazhohen edhe prindërit.
- Shpallet fituesi (ose fituesit nëse është vendosur të ketë më shumë se një).
- Hartohet proces-verbali i zgjedhjeve dhe dorëzohet në komisionin qendror të zgjedhjeve.
- Njohja e rezultateve nga komisioni qendror i zgjedhjeve. Fituesit i jepet mandati 1 vjeçar si **anëtar përfaqësues në qeveri**.

Në këtë moment delikat duhet bërë kujdes për kandidatët që nuk kanë fituar. Nga një këndvështrim motivues edhe ata duhen trajtuar “si të suksesshëm” duke i përgëzuar për kurajën dhe përkushtimin që treguan.

Kandidatët për kryetarin e qeverisë

Mësuesët ndihmues, 2-3 ditë pas shpalljes së përfundimeve të zgjedhjeve, organizojnë mbledhjen e parë të Qeverisë ku propozohen kandidatët për Kryetarin e Qeverisë.

Kryetar do të zgjidhet njëri nga anëtarët. Kandidatët për vendin e kryetarit do të propozohen nga anëtarët. Kryetari i Qeverisë së nxënësve është e këshillueshme të zgjidhet nga vitet e fundit të shkollës (nga klasat 8 ose 9 për shkollat 9-vjeçare dhe nga klasat 11 ose 12 për shkollat e mesme) dhe e preferueshme nga anëtarët e qeverisë së mëparshme të cilët janë rizgjedhur si përfaqësues

të klasave, sepse janë më të mirinformuar për problemet e shkollës dhe e kanë tashmë një përvojë që duhet shfrytëzuar. Kriteret për kryetarin duhen të jenë pretenduese.

Pavarësisht nga mënyra e zgjedhjes, kandidati për kryetar qeverie duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në rregulloren e Qeverisë së nxënësve ose në mungesë të saj ato të hartuara enkas për këtë qëllim që kanë të bëjnë me:

- cilësi të karakterit (i ndershëm, i sinqertë, i përkushtuar, i vullnetshëm, i gatshëm për të ndihmuar të tjerët etj)
- aftësitë komunikuese (shprehet qartë, respekton rregullat e komunikimit etj)
- aftësitë organizuese, planifikuese e drejtuese (i mire organizuar, largpamës, etj)
- arritjet në të nxënë (përcaktohet kufiri për notën mesatare, etj)
- kodin e sjelljes
- përvojat e mëparshme (a ka qenë ndonjëherë në pozicione drejtuese, a ka marrë pjesë në organizata të tjera jashtë shkolle etj.)

Kandidati për kryetar qeverie duhet të ketë edhe dy rekomandime nga mësuesit e shkollës (model me kriteret për rekomandimin, Anex 1).

Nxënësit kandidatë dhe nxënësit zgjedhës duhet të jenë të informuar për detyrat e pozicionit të kryetarit të qeverisë.

Detyrat kryesore të kryetarit të qeverisë:

- drejton, dhe kontrollon me efikasitet dhe efikasitet të gjithë punën e Qeverisë së nxënësve
- planifikon dhe drejton me efikasitet mbledhjet e Qeverisë së nxënësve
- përfaqëson Qeverinë e nxënësve te Drejtori i shkollës
- përfaqëson, Qeverinë e Nxënësve në Bordin e shkollës
- merr pjesë në mbledhjet e këshillit të mësuesve në varësi të tematikës që diskutohet
- bashkëpunon dhe koordinon struktura të ngritura brenda Qeverisë së nxënësve

Në rregulloren e Qeverisë së nxënësve detyrat e mësipërme mund të detajohen, saktësohen ose plotësohen.

Zhvillimi i zgjedhjeve për kryetarin e Qeverisë

Për vendin e kryetarit konkurrojnë më shumë se një kandidat.

Qeveria e nxënësve e zgjedh Kryetarin me votim të fshehtë.

Votimi për kryetarin e qeverisë kryhet nga një numër i konsiderueshëm nxënësish të shkollës i cili varet nga numri total i nxënësve.

Procedura për zgjedhjen e kryetarit të Qeverisë ndjek hapat e mëposhtme.

- Nga çdo klasë e shkollës, për të marrë pjesë në zgjedhjen e kryetarit, zgjidhen me votim disa nxënës (përshembull 10 nxënës). Një nga mënyrat është: çdo dy nxënës të klasës të propozojnë një nxënës. Një nxënës nuk mund të propozojë 2 herë. Hartohet lista e të propozuarve. Me votim të fshehtë, çdo nxënës voton për 10 veta. Komisioni zgjedhor i klasës grumbullon fletët e votimit, i shqyrton dhe shpall 10 më të votuarit
- Kandidati për kryetar qeverie propozohet nga një grup prej 5 anëtarësh me miratimin e të propozuarit, ose vetë propozohet.
- Komisioni qendror i zgjedhjeve shqyrton kandidaturat dhe miraton ato kandidatura që plotësojnë kriteret e paracaktuara.
- Kandidatët e miratuar paguajnë një kuotë të caktuar që derdhet në buxhetin e Qeverisë së nxënësve dhe është e pakthyeshme.
- Menjëherë pas miratimit kandidatët e propozuar fillojnë fushatën. Fushata zgjat rreth 1 javë.
- Pasi kandidatët kanë mbaruar fushatën kryhen zgjedhjet
- Përgatiten fletët e votimit (model fletë votimi, aneks 2) nga komisioni qendror i zgjedhjeve, me emrat e kandidatëve.
- Votojnë të zgjedhurit nga klasat.
- Secili votues do të votojë për kandidatin që preferon. Votimi kryhet i fshehtë.
- Votimi monitorohet nga komisioni qendror i zgjedhjeve dhe nga nxënës të shkollës të angazhuar për këtë qëllim.
- Numërohen votat. Numërimi i votave kryhet nga komisioni qendror i zgjedhjeve dhe monitorohet nga nxënës, mësues e prindër. Në numërimin e votave mund të angazhohen edhe prindërit.
- Hartohet proces-verbali i zgjedhjeve dhe dorëzohet në komisionin qendror të zgjedhjeve.
- Shpallet fituesi
- Njohja e rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Fituesit i jepet mandati 1 vjeçar si **kryetar i Qeverisë së nxënësve**.

Ashtu si në zgjedhjet e përfaqësuesve edhe momenti i shpalljes së fituesit për vendin e kryetarit të qeverisë është delikat dhe duhet bërë kujdes për kandidatët që nuk kanë fituar. Nga një këndvështrim motivues edhe ata duhen trajtuar “si të suksesshëm” duke i përgëzuar për kurajën dhe përkushtimin që treguan.

Pak fjalë për fushatën

Fushata që bën kandidati është një nga veprimtaritë e rëndësishme të zgjedhjeve. Një fushatë dinjitoze ndikon pozitivisht në dinjitetin e Qeverisë së nxënësve.

Parimet e fushatës

- Strategjia që do të përdoret për fushatën duhet të fokusohet në aftësitë e kandidatit dhe nuk duhet të dëmtojë reputacionin e kandidatëve të tjerë.
- Kandidati mund të bëjë vetëm ato premtime të cilat ai është i bindur që do t'i mbajë.
- Fushata do të zhvillohet në përputhje me rregullat e vendosura.

Këshilla për ju kandidatë

Mënyra më e mirë që një kandidat të fitojë votat është **të transmetojë qartë idetë e tij**, të tregojë që ka ide dhe kurajo për të ndryshuar gjërat për të mirën e shkollës. Natyrisht që kjo varet nga specifikat e shkollës dhe të problemeve të saj. Sigurisht që ka një sërë problemesh të shkollës që janë jashtë fuqive tuaja për t'i ndryshuar, por ka edhe mjaft të tjera të cilat me dëshirën e mirë dhe me këmbëngulje mund të zgjidhen nga Qeveria e nxënësve. Përshembull nëse e ndjeni që shkolla nuk është sa duhet e lidhur me komunitetin parashtroni ide se si mund ta forconi këtë lidhje.

Gjëja e parë që duhet t'i shkojë ndërmend një kandidati, veçanërisht atij për kryetar qeverie, në organizimin e fushatës së tij është që **të bëhet sa më i njohur për nxënësit e shkollës**. Fitorja varet edhe nga fakti se sa nxënës të njohin se kush je. Kjo gjë fillon edhe duke shtuar një shenjë të vogël në veshjen tuaj që nxënësit të fillojnë t'ju njohin fizikisht.

Kushtojini **vëmendje komunikimit me zgjedhësit** me shumë mënyra, përshembull:

- Bisedoni lirshëm me ta në mjediset e shkollës
- Parashtroni idetë tuaja, sa më konkretisht, në gazetën e shkollës nëse ka të tillë ose në website-in e krijuar posaçërisht për këtë qëllim.
- Duhet të mbani një fjalim para zgjedhësve, kohëzgjatja e të cilit është e përcaktuar me rregullore dhe varet nga numri i kandidatëve. Fjalimi duhet të jetë i strukturuar mirë, dhe të transmetojë qartë dëshirën dhe vullnetin tuaj për të bërë realitet premtimet të cilat nuk duhet të jenë shumë dhe njëri prej tyre duhet të jetë në fokusin kryesor të punës së ardhshme.
- Edhe debatet në publik, me kandidatët e tjerë mund të konsiderohen si pjesë e fushatës.

Fushata mund të përfshijë edhe **shpërndarjen e posterave**. Përmbajtja e posterave, sasia e tyre, vendi ku do të ngjiten, sa kohë do të rrinë, momenti kur duhet të hiqen, përcaktohen me rregullore dhe miratohen nga Drejtoria e shkollës ose Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Posterat duhet të jenë mbështetëse vetëm për një kandidat dhe të mos përmbajnë informacion negativ për kandidatët e tjerë.

Nëse doni që të fitoni, rekomandohet që gjatë fushatës të **zgjidhni një slogan (parullë)** i cili duhet të jetë:

- i shkurtër
- të “godasë në shenjë”
- me gjuhë të thjeshtë dhe të qartë

- i lehtë për t'u mbajtur mend
- i qartë se i kujt është (p.sh. të shkruhet edhe emri), përshembull: “për të mirën e të gjithëve votoni (Emri)”, “besoni te (Emri)”, “jepini shkollës tonë një shans, votoni (Emri)”

KREU 3

ECURIA E PUNËS

Menjëherë pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për Kryetarin e qeverisë dhe marrjes së mandateve, Qeveria e nxënësve fillon punën.

Qeveria paraardhëse (nëse ka të tillë) përgatit ceremoninë e ndërrimit të qeverive dhe bën dorëzimin me shkrim të inventarit dhe dokumentacionit.

Ku mbështetet

Puna e Qeverisë së nxënësve mbështetet në **parimin**: “Qeveria e nxënësve përfaqëson të gjithë nxënësit e shkollës, u jep mundësi të gjithëve të përfshihen në zgjidhjen e problemeve të ndryshme të jetës së shkollës dhe bashkëpunon me drejtuesit, mësuesit, prindërit në të mirë të shkollës e të vetë nxënësve”.

Një qeveri nxënësish, e formuar rishtazi, ka nevojë për një dokument i cili të përshkruajë rolin dhe përgjegjësitë e Qeverisë së nxënësve dhe të mundësojë funksionimin me efektivitet të saj. Ky dokument quhet “**Rregullore e brendshme e Qeverisë së nxënësve të shkollës X (emri shkollës)**”. Të gjitha vendimet dhe veprimtaritë që ndërmerr Qeveria e nxënësve do të bazohen te rregullorja e saj.

Në ato raste kur në shkollë ka pasur qeveri nxënësish, anëtarët e qeverisë të re e marrin të gatshme rregulloren, e studiojnë dhe e ripunojnë nëse kanë ide të reja dhe nëse ka ndryshime në legjislacion ose kanë dalë udhëzime të reja që duhen reflektuar. Në ato raste kur Qeveria e nxënësve krijohet për herë të parë, anëtarët e saj duhet ta hartojnë rregulloren.

Shkalla e detajimit e rregullores duhet të jetë aq sa të mundësojë dhe lehtësojë funksionimin e Qeverisë së nxënësve në kushtet e shkollës dhe të mos pengojë fleksibilitetin për situata të veçanta.

Gjatë hartimit të rregullores rekomandohen konsulta me Drejtuesit e shkollës dhe anëtarë të stafit të cilët kanë përvoja në këtë fushë.

Rregullorja e brendshme e Qeverisë së nxënësve duhet të rakordojë me rregulloren e brendshme të shkollës. Për këtë arsye, para miratimit përfundimtar, rregullorja diskutohet me Drejtuesit e shkollës, Bordin e shkollës, përfaqësues nga mësuesit, dhe dëgjohen me kujdes të gjitha sugjerimet e tyre.

Rregullorja miratohet nga anëtarët, në një mbledhje të Qeverisë së nxënësve, dhe nga Drejtori i shkollës.

Në vijim janë një sërë çështjesh që duhen përfshirë në rregullore.

- Përshkrim i shkurtër i rolit dhe objektivave të Qeverisë së nxënësve
- Sa nxënës do të zgjidhen gjithsej dhe sa nxënës do të zgjidhen për klasë
- Kur, si do të zhvillohet procesi zgjedhor (propozimet, votimet, fushatat)
- Kriteret për kandidatët
- Përbërja e kryesisë
- Detyrat e kryesisë
- Kur dhe si krijohen komisionet brenda qeverisë, funksionimi i tyre
- A do të ketë mësues ndihmues, nëse po, a ka kritere për të
- Si do të tërhiqen ide nga të gjithë nxënësit e shkollës
- Periodiciteti i mbledhjeve të Qeverisë së nxënësve dhe caktimi i një dite fikse
- Rregullat për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve (p.sh. njoftimi, përgatitja e axhendës, drejtimi i mbledhjes,
- Mbledhjet jashtë rradhe (p.sh. takim me Drejtorin e shkollës për probleme që nuk presin)
- Çfarë lloj mbledhjesh thirren (të gjithë, vetëm kryesia?)
- Marrja e vendimeve në mbledhje (sa anëtarë duhet të jenë prezent), si veprohet kur ka vota të barabarta
- Me kë dhe si vendosen ura komunikimi
- Kujt i dërgohen raporte të punës
- Cilat çështje kërkojnë miratimin Drejtorit të shkollës ose të organeve kolegjiale
- Si shpërndahet informacioni për punën e Qeverisë së nxënësve (gazeta, website etj.)
- Si vlerësohet puna e Qeverisë së nxënësve
- Si dhe ku raportohet puna e kryer (p.sh. përfaqësuesit raportojnë në qeveri dhe në klasë)
- Cili raporton për punën e kryer (p.sh. raportimin vjetor e bën kryetari)
- Si dhe ku përfaqësohet Qeveria e nxënësve në mbledhjet e tjera të shkollës
- Si sigurohen dhe si përdoren fondet
- Nëse lirohet një vend në qeveri, si veprohet?
- A mund të lirohet nga detyra një anëtar i qeverisë nga qeveria?
- Si hartohet e si miratohet rregullorja?
- Si mund të ndryshohet rregullorja
- Sigurimi i kushteve të domosdoshme të punës (mjedisi, pajisjet, interneti etj.)
- Simbolet (logoja vula)

Secila qeveri nxënësish harton një rregullore të përshtatshme për shkollën e saj. Specialisti i DAR/ZA, i ngarkuar për Qeverinë e nxënësve, i ndihmon në hartimin e rregullores duke u dhënë modele rregulloresh të hartuara mirë.

Që në fillimet e punës së saj Qeveria e nxënësve duhet ta konsiderojë të dobishme **të kërkojë herë pas here mendimin e drejtuesve të shkollës, mësuesve e prindërve** dhe të gjejë mënyra

për ta bërë këtë gjë. Nëse një mësues apo një prind angazhohet vit pas viti në rolin e konsulentit shtohet mundësia për vazhdimësinë e punës së qeverive të nxënësve në atë shkollë.

Drejtimit kryesore

Puna e Qeverisë së nxënësve është e lidhur me funksionin dhe rolin e saj në shkollë. Drejtimit kryesore të punës janë:

- komunikimi dhe këshillimi me të gjithë nxënësit e shkollës
- përfshirja e sa më shumë nxënësve në veprimtaritë e Qeverisë së nxënësve
- bashkëpunimi me mësuesit e shkollës, Bordin e shkollës, Drejtuesit dhe prindërit
- planifikimi i veprimtarive për të gjithë vitin dhe menaxhimi i tyre
- sigurimi dhe menaxhimi i fondeve¹

Si organizohet puna

Të gjithë anëtarët e Qeverisë së nxënësve duhet të përfshihen në veprimtaritë e saj. Në organizimin e punës (në planifikimin dhe ndarjen e detyrave), teknikisht është e pamundur që të përfshihen të gjithë. Për këtë arsye, ndërmjet të zgjedhurve, përveç postit të kryetarit, caktohen edhe disa **poste të tjera** për ato detyra që janë të përhershme. Të tillë janë **sekretari** dhe **financieri**. Kryetari, financieri dhe sekretari formojnë **kryesinë e Qeverisë së nxënësve**. Në varësi të specifikave të shkollës dhe numrit të anëtarëve të Qeverisë së nxënësve, kryesisë mund t'i shtohet edhe posti i **nënkryetarit** të Qeverisë së nxënësve.

Detyrat kryesore të secilit anëtar të kryesisë

Detyrat kryesore të kryetarit të Qeverisë së Nxënësve janë përcaktuar në Kreun 2.

Detyrat e nënkryetarit të qeverisë:

- nënkryetari zëvendëson kryetarin dhe kryen detyrat e tij nëse ai mungon;
- nënkryetari, gjatë gjithë mandatit të Qeverisë ndihmon kryetarin në mbarëvajtjen e punës.

Detyrat kryesore të financierit:

- financieri është përgjegjës për financën e Qeverisë së nxënësve
- financieri bashkëpunon dhe mbikëqyret nga mësuesi ndihmues ose nga ndonjë mësues tjetër i shkollës

¹ Në planifikimin e punës nga qeveritë e shkollave 9-vjeçare ky aspekt zë një vend shumë të vogël se sa në planin e qeverive të shkollave të mesme.

- shqyrton të gjitha mundësitë financiare për projektet e paraqitura nga ana e Qeverisë së nxënësve dhe i gjykon duke u nisur nga mundësitë financiar
- harton informacione të nevojshme dhe raporte financiare dhe i paraqet në Qeverinë e nxënësve dhe në Bordin e shkollës
- mban dokumentacionin përkatës mbi financën dhe e ruan atë
- financieri ka për detyrë edhe të marrë pjesë dhe të japë ide dhe mendimin e tij edhe në të gjitha diskutimet për çështje të ndryshme që trajtohen në mbledhjet e qeverisë

Planifikimin e punës së tij, financieri e kryen në përputhje me planin e përgjithshëm të punës dhe me miratimin e anëtarëve të tjerë të Qeverisë së nxënësve në mbledhje të posaçme. Për disa aspekte të punës së tij, në përputhje me rregulloren e shkollës, kërkohet miratimi i Bordit të shkollës dhe i Drejtorit të shkollës.

Detyrat kryesore të Sekretarit:

- mban, kujdeset dhe është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e Qeverisë së nxënësve
- mban procesverbal për çdo mbledhje të Qeverisë së nxënësve dhe e ruan atë;
- është përgjegjës për shpërndarjen e informacioneve në lidhje me punën e Qeverisë së nxënësve
- ka për detyrë edhe të marrë pjesë dhe të japë ide dhe mendimin e tij edhe në të gjitha diskutimet për çështje të ndryshme që trajtohen në mbledhjet e qeverisë

Planifikimin e punës së tij, sekretari e kryen në përputhje me planin e përgjithshëm të punës dhe me miratimin e kryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë së nxënësve.

Në rregulloren e brendëshme, detyrat e sekretarit dhe të financierit mund të saktësohen detajohen ose plotësohen.

Si zgjidhen anëtarët e kryesisë

- Zgjedhja e kryetarit të qeverisë është përshkruar në kreun 2.
- Sekretari dhe financieri zgjidhen në mbledhjen e parë të Qeverisë së nxënësve ose në një nga mbledhjet e para.
- Nënkyetar qeverie zgjedhin ato qeveri nxënësish që kanë numër të madh anëtarësh (mbi 20). Nëse vendoset për të pasur edhe nënkryetar, nënkryetarin e zgjedh kryetari.
- Komisioni qendror i zgjedhjeve kryeson dhe mbikëqyr edhe zgjedhjet për kryesinë.
- Kryesia e qeverisë zgjidhet me votim të fshehtë, nga anëtarët e qeverisë. Votimi bëhet për secilin post. Kriteret dhe detyrat për secilin post, si rregull, janë të përshkruara në rregulloren e qeverisë së mëparshme dhe u jepen anëtarëve të qeverisë paraprakisht që të njihen me to për të bërë zgjedhjen e duhur. Në mungesë të rregullores, një grup pune i

ngritur nga kryetari, me vetë kryetarin, 1-2 mësues dhe 2-3 nxënës i harton duke u bazuar në legjislacionin përkatës dhe udhëzimet e MASH e të DAR/ZA.

Procedura e zgjedhjeve është e ngjashme me ato të zgjedhjes së përfaqësuesve në klasa dhe ndjek hapat në vijim.

- Kandidati për secilin nga postet propozohet nga 4-5 anëtarë ose vetë propozohet. Propozimi mbështetet në kriteret e paracaktuara dhe në përshkrimin e detyrave të tij në kryesi.
- Pas propozimeve, hartohet lista e kandidatëve për secilin post, rreth 3-4 kandidatë.
- Secili kandidat mban një fjalim të shkurtër para anëtarëve të qeverisë ku prezanton veten dhe idetë e tij për të argumentuar kandidimin. Fjalimi është mëse i domosdoshëm edhe për faktin se anëtarët e qeverisë nuk njihen të gjithë me njëri tjetrin.
- Përgatiten fletët e votimit, veç e veç ose të kombinuara. Në fletë vendosen emrat e kandidatëve për secilin post.
- Kryhet votimi i fshehtë.
- Numërohen votat dhe shpallet kandidati me më shumë vota.
- Fituesit i jepet mandati 1- vjeçar për postin për të cilin ka kandiduar.
- Votimet monitorohen nga nxënës të shkollës, mësues , prindër.

Për një organizim sa më të mirë të punës, Qeveria e nxënësve mund të formojë edhe **komisione (grupe pune me disa anëtarë), të përhershme ose të përkohshme** që kanë lidhje me një fushë të caktuar veprimtarie (përshembull komisioni për ruajtjen e mjedisit). Komisionet hartojnë planet e punës që kanë të bëjnë me fushën e tyre dhe i paraqesin për miratim në një nga mbledhjet e Qeverisë së nxënësve. Gjithashtu raportojnë periodikisht për punën e kryer. Detaje për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve përshkruhen në rregulloren e brendshme të Qeverisë së nxënësve.

Komunikimi

Komunikimi i dyanshëm ndërmjet Qeverisë së nxënësve dhe nxënësve të shkollës; ndërmjet Qeverisë së nxënësve dhe Drejtuesve të shkollës , mësuesve e prindërve, është shumë i rëndësishëm dhe synon që i gjithë komuniteti i shkollës të kuptojë dhe të ndihmojë në realizimin e objektivave të Qeverisë së nxënësve.

Nga njëra anë nxënësit duhet të informohen rregullisht për veprimtaritë e Qeverisë së nxënësve . Nga ana tjetër atyre duhet t'u krijohet mundësia (jo vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tyre) për të shprehur pikëpamjet e tyre për çështjet që diskutohen në Qeverinë e nxënësve dhe për të propozuar çështje për diskutim.

Përfaqësuesit e çdo klase rregullisht duhet të informojnë dhe të dëgjojnë opinionet e idetë e nxënësve të klasës.

Një komunikim i frytshëm dypalësh realizohet konkretisht me forma e mjete të ndryshme disa prej të cilave rekomandohen në vijim.

- Brenda në shkollë, në një vend të dukshëm nga të gjithë, vendoset një **tabelë** në të cilën afishohen plani i veprimtarive dhe veprimtaritë e Qeverisë së nxënësve të kryera muaj pas muaji, tematika dhe data e mbledhjes së ardhshme, fotografi të anëtarëve dhe nga veprimtaritë, ide të dhëna nga nxënësit e shkollës për veprimtaritë etj.
- Botimi i një **gazete, reviste ose krijimi i një website** është një mënyrë e dobishme informimi sepse ndërjegjëson për arritjet, për planet në vazhdim, dhe rrit interesin dhe pozitivitetin për punën e Qeverisë së nxënësve. Aty mund të shprehen pikëpamje dhe qëndrime për problemet e shkollës dhe komunitetit rreth shkollës. Të gjithë nxënësit e shkollës ftohen të shkruajnë artikuj dhe më pas përzgjidhen sipas disa kriterëve.
- Përfaqësuesit e klasave **informojnë rregullisht klasën e tyre** për diskutimet, vendimet, njoftimet e bëra në mbledhjet e Qeverisë së nxënësve.
- Organizohen **mbledhje të zgjeruara** të Qeverisë së nxënësve ku ftohen të marrin pjesë nxënës të cilët kanë ide dhe sugjerime për të diskutuar lidhur me çështjen që do të trajtohet ose propozime për punën në vazhdim.
- Zhvillohen **biseda** me nxënësit e shkollës për çështje që janë diskutuar ose që do të diskutohen në mbledhjet e Qeverisë së nxënësve.
- Zhvillohen **takime periodike** me drejtuesit e shkollës, Bordin e shkollës, mësuesit e Këshillin e prindërve.
- **Informohen periodikisht** (me gojë ose me shkrim) për punën (e kaluar dhe të ardhme) e Qeverisë së nxënësve, drejtuesit e shkollës, Bordi, mësuesit e Këshilli i prindërve, jo thjesht për qëllim informimi, por edhe për të marrë mendime e sugjerime prej tyre.
- Qeveria e nxënësve **përfaqësohet** në mbledhjet e stafit dhe të Bordit të shkollës.
- **Këshillime** me drejtuesit e shkollës, Bordin, mësuesit e këshillin e prindërve për probleme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e shkollës.
- Herë pas here **ftohen drejtues, nxënës, mësues, drejtues, prindër të marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë së nxënësve**.

Njërit nga anëtarëve të Qeverisë së nxënësve ose një komisioni të ngritur enkas mund t'i caktohet si detyrë që të merren komunikimin.

Planifikimi dhe vlerësimi i punës

Qeveria e nxënësve mund të hartojë e të zbatojë **projekte** të cilat:

- janë në interes të procesit mësimor

- ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset e vendimmarrjes
- edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike
- ndikojnë në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale brenda dhe jashtë shkollës
- aftësojnë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet mosha e tyre
- përmirësojnë kushtet e shkollës
- ndikojnë në ruajtjen e mjedisit
- ndikojnë pozitivisht në klimën e shkollës
(model veprimtarish, Aneksi 3)

Plani vjetor dhe plani mujor

Në mbledhjen e parë ose të dytë, Qeveria e nxënësve harton **planin vjetor**, ku planifikohen veprimtaritë për të gjithë vitin.

Është e dobishme që për hartimin e planit vjetor të merret mendimi i sa më shumë nxënësve. Plani vjetor duhet të jetë realist, domethënë të parashikojë veprimtari që mund të kryhen. Çdo veprimtari, që të rezultojë e suksesshme, duhet menduar e planifikuar me kujdes dhe me detaje.

Plani vjetor hartohet mbi bazën e prioriteteve të identifikuara nga secila klasë e shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Hartimi i planit vjetor duhet t'i referohet edhe planit vjetor të shkollës për të evituar paralelizmat dhe kundërshtitë. Për këtë arsye organizohen takime konsultative me Drejtorin e shkollës dhe me Bordin e shkollës. Varianti përfundimtar, pas prezantimit në secilën klasë, shpallet që të bëhet i njohur për të gjithë dhe një kopje i dërgohet Drejtorit të shkollës.

Përgjatë zbatimit të planit vjetor, vendimi për ndonjë ndryshim merret me shumicë votash në një mbledhje të Qeverisë.

Plani vjetor detajohet në **plane mujore** (një model plani vjetor i detajuar sipas muajve gjendet në Aneks 4).

Pasi mbarimit të një veprimtarie, është në dobi të punës të gjendet koha për ta vlerësuar: a ishte e suksesshme, çfarë problemesh pati, çfarë duhet parasysh për herë tjetër etj.

Në fund të vitit vlerësohet e gjithë puna: çfarë është arritur, çfarë nuk është arritur dhe pse. Për këtë qëllim hartohet **raporti përfundimtar** i cili merr parasysh edhe opinionet me shkrim nga Drejtori, Bordi i shkollës dhe Këshilli i prindërve. Të gjithë nxënësve të shkollës u jepet mundësia të lexojnë raportin përfundimtar.

Takime (mbledhje) pune

Qeveria e nxënësve organizon takime (mbledhje) pune me anëtarët e saj.

Mbledhjet mund të lihen në një ditë fikse të javës ose të muajit. Megjithatë, zhvillohen edhe takime tematika e të cilave nuk mund të presë derisa sa të vijë dita e caktuar. Anëtarët e Qeverisë së nxënësve duhet të takohen jo më rrallë se një herë në muaj.

Të gjethe pjesëmarrësit duhet të njoftohen një javë përpara për **tematikën e mbledhjes** në mënyrë që të kenë kohë të përgatiten për diskutim. Tematika e mbledhjes duhet të reflektojë sugjerimet e anëtarëve të qeverisë dhe të nxënësve të shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Drejtuesi i mbledhjes duhet të bëjë kujdes që të gjithëve t'u krijohet mundësia për të diskutuar.

Vendimet në mbledhje duhet të merren me konsensus. Për të marrë një vendim caktohet në parim numri i domosdoshëm i anëtarëve që duhet të jenë prezent.

Mbledhjet duhet të jenë efçente dhe të mos zgjatin shumë e të bëhen të mërzitshme.

Në çdo mbledhje të Qeverisë së nxënësve, sekretari mban **procesverbal**, ku shënohen data, qëllimi, pjesëmarrja, diskutimet dhe vendimet. Procesverbalet mbahen në të njëjtën fletore ose bllok sepse janë pjesë e dokumentacionit që duhet ruajtur.

Në mbledhjet e punës duhet të respektohet **etika e komunikimit**, të mos lejohen fjalë fyese dhe sjellje të pahijshme.

Qeveria organizon edhe **mbledhje të zgjeruara**, përshembull me pjesëmarrjen edhe të Drejtuesve të shkollës, të këshillit të prindërve etj.

Qeveria e nxënësve organizon edhe **mbledhje më të ngushta** përshembull takime të një grupi nga Qeveria e nxënësve me drejtuesit e shkollës etj.

Dokumentacioni

Se si mbahet dhe ruhet dokumentacioni është një tregues i rëndësishëm i punës së Qeverisë së nxënësve. Një dokumentacion i saktë dhe i ruajtur me kujdes tregon seriozitetin e punës dhe i shërben qeverive pasardhëse si dhe historikut të shkollës.

Dokumentacioni përmban:

- regjistrin themeltar të anëtarëve të Qeverisë së nxënësve në vite, ku shënohen emri e mbiemri i anëtarit të Qeverisë së nxënësve, fotografia, data e zgjedhjes dhe e dhënies së mandatit, klasa që e ka zgjedhur, detyra që ka patur, shënime plotësuese në se lind nevoja për këtë gjë si: largimi, përjashtimi, masa dënimi ndaj tij etj.
- regjistrin financiar, ku shënohen të gjithë kontributet, hyrje – daljet dhe dokumentet përkatëse, vërtetuese të shpenzimeve të bëra
- dokumentacionin e zgjedhjeve për Qeverinë e nxënësve (CV-të e kandidatëve, fletët e votimit për çdo klasë dhe për kryetarin)
- procesverbale mbledhjesh, plane pune, plane veprimtarish, fotografi, regjistrime;

- inventarin fizik dhe përshkrues të mjeteve dhe dokumentacionit disponibël

Dokumentacioni ruhet në arkivin e Qeverisë së nxënësve, duke përfshirë çdo gjë të shkruar, fotografuar, filmuar apo regjistruar.

Biblioteka

Krijimi i një biblioteke është në funksion të cilësisë së punës së një Qeverie nxënësish.

Biblioteka përmban literaturë në shqip dhe në gjuhë të huaj që ndihmon, direkt ose indirekt, punën e Qeverisë së nxënësve.

Inventarizimi i bibliotekës kryhet sipas rregullave bibliotekare.

Një anëtar i Qeverisë së nxënësve ngarkohet për dokumentacionin dhe bibliotekën (administrimin, inventarizimin, ruajtjen dhe përpunimin).

Sigurimi i Fondeve

Qeveria e nxënësve mund të kërkojë mbështetje financiare nga subjekte të ndryshme për realizimin e veprimtarive të veta të planifikuara.

Qëllimi se përse do të kërkohen dhe si do të përdoren fondet vendoset kolegjisht në mbledhje dhe u bëhet e ditur nxënësve të shkollës.

Përdorimi i fondeve kërkon zbatimin e disa rregullave të cilat janë të njëjta me rregullat financiare të shkollës. Me sqarimin e rregullave financiare merret mësuesi ndihmues ose ndonjë mësues tjetër i shkollës i cili bashkëpunon ngushtë me financierin e Qeverisë së nxënësve.

Shpërndarja e Qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve shpërndahet kur mbaron mandati i saj 1 vjeçar.

Në raste të jashtëzakonshme, Qeveria e nxënësve mund të shpërndahet para përfundimit të mandatit të saj. Propozimin për shpërndarjen e parakohshme e bën Këshilli i mësuesve të shkollës dhe e dërgon për miratim në Drejtorinë Arsimore.

Në rrethanat që diktojnë shpërndarjen e parakohshme të Qeverisë së nxënësve përfshihen rastet në të cilat:

- një numër i konsiderueshëm (më i madh se 1/3) anëtarësh të saj kanë manifestuar thyerje serioze të rregullave të sjelljes të përcaktuara në rregulloren e shkollës

- veprimtari të Qeverisë së nxënësve kanë rrezikuar mirëqënien e stafit dhe nxënësve të shkollës
- konstatohen parregullsi në zgjedhje
- konstatohen parregullsi financiare

Nëse Qeveria e nxënësve shpërndahet më pak se tre muaj para përfundimit të mandatit, nuk zgjidhet qeveri tjetër, në të kundërt mund të zgjidhet qeveri e re.

Lirimi dhe zëvendësimi i një anëtari ose disa anëtarëve

Një anëtar i Qeverisë së nxënësve të një shkolle zëvendësohet nëse ai për arsye të ndryshme nuk ndjek rregullisht këtë shkollë.

Qeveria e nxënësve, me shumicë votash mund të lirojë nga detyra një ose disa anëtarë, nëse nuk kanë marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm (i përcaktuar në rregulloren e Qeverisë së nxënësve) mbledhjesh; nuk janë të angazhuar në veprimtaritë; kanë manifestuar sjellje që bien në kundërshtim me rregulloren e shkollës. Lirimi nga detyra shoqërohet edhe me argumentimin me shkrim, dhënë anëtarit të liruar.

Lirimi dhe zëvendësimi i jo më shumë se 1/3 e anëtarëve të qeverisë, në rastin e thyerjes së rregullave të rregullores së shkollës mund të bëhet edhe me propozim të këshillit të mësuesve. Nëse Qeveria e nxënësve nuk e miraton propozimin e mësuesve, argumentimi me shkrim i të dy palëve dërgohet për vendimmarrje në Drejtorinë arsimore.

Duhet pranuar edhe largimi i një anëtari me dëshirën e tij për shkaqe të arsyeshme. Ai bën kërkesën dhe e dorëzon në kryesi. Nëse kryesia gjykon që shkaqet janë të arsyeshme, kërkesa paraqitet në një nga mbledhjet e Qeverisë së nxënësve dhe me shumicë votash merret vendimi.

Nëse një anëtar është larguar, në Qeverinë e nxënësve është krijuar një vend bosh i cili plotësohet sipas rregullave për zgjedhjet për atë vend.

Aneks 1

Model kriteresh për rekomandimin

Aftësi për të udhëhequr			
Shkëlqyer	Mbi mesataren	Mesatare	Nën mesataren
Aftësi verbale të komunikimit			
Shkëlqyer	Mbi mesataren	Mesatare	Nën mesataren
Aftësi të komunikimit me shkrim			
Shkëlqyer	Mbi mesataren	Mesatare	Nën mesataren
Ndjenja e përkushtimit për shkollën			
Shkëlqyer	Mbi mesataren	Mesatare	Nën mesataren
Aftësi organizimi			
Shkëlqyer	Mbi mesataren	Mesatare	Nën mesataren
Përfshirja në veprimtari ekstrakurrikulare			
Shkëlqyer	Mbi mesataren	Mesatare	Nën mesataren

Aneks 2

FLETA E VOTIMIT

VENDOSNI SHENJEN X NE KUTINE PRANE EMRIT TE KANDIDATIT PER KRYETAR TE QEVERISE SE NXENESVE QE JU DESHIRONI TE VOTONI:

EMRI _____

EMRI _____

EMRI _____

EMRI _____

Aneks 3

Model aktivitetesh



19-Tetor 2008: Shejterimi i Nene Terezës.

Ne perkujtim te shejterimit te nene Terezës qeveria e nxenesve ne bashkepunim me mesuesit e letersise dhe te muzikes organizuan nje program festiv ku nxenesit perkujtuan me shume tespekt dhe nderime gruan shqiptare te cilen mbare bota e quajti Nene. Koncerti percillte vjetsha, kenge dhe ese te bukura qe nxenesit kishin thurur per Nene Terezën.

28-31 Tetor 2008: Java e ujit.

Qeveria e nxenesve ne bashkepunim me mesues te biokimise, muzikes, vizatimit dhe gjeografise kane organizuar aktivitate te ndryshme si biseda sensibilizimi per ndotjen e ujit. Si te kujdesemi qe te kemi uje te bollshem dhe te pastër. Kjo duhet te filloje nga ne nxenesit e shkollave, prandaj kjo jave ishte e mbushur me aktivitate te ndryshme si ekspozite vizatimesh e organizuar nga nxenesit e shkolles 9-vjecare, kane sjelle me punimet e tyre ku shprehnin idete e tyre per egzistencen e nje bote pa uje. Tjeter, ishte koncerti i pergatitur nga nxenesit, ku ne qender te te cilit ishte drama, subjekti i te ciles ishte e perqendruar ne fillimin e ekzistences jetes.

14-22 Nentor 2008: 100-vjetori i Kongresit te Manastirit

100-vjetori i Kongresit te Manastirit ose alfabetit te gjuhes Shqipe, nje nder evenimentet me te rendesishme per popullin tone. Ishte pikerisht kjo jave qe solli per shqiptaret nje jave plot festime. Ketyre festimeve i bashkohet edhe shkolla jone ku me date 19.11.2008 organizoi nje aktivitet festiv duke sjelle e perkujtuar atmosferen e krijuar ne manastir 100-vjet me pare. Me respect dhe nderime sollem pjese nga perpjekjet qe bene atdhetaret tane per te na leneneve sot te bukuren dhe te embleme gjuhen shqipe.

Presidenti: Ibrahim Basha.



Aneks 4

Model plani vjetor

**PLAN I PUNES I QEVERISE SE NXENESVE
2008-2009**

Shkollë "1 Qeshori"

	VEPRIMTARITE	PERGJEGJES	AFATI
1	Sensibilizimi i nxenesve per zgjedhjen e senatorve	Kordinatori dhe mesuesi kujdestar	Muaj Tetor 2008. 1 - 10
2	Zgjedhja e Sanatorve	Drejtoria e shkolles.	10 - 16 Tetor 2008.
3	Mbledhja e Qeverise dhe zgjedhjet e persidentit dhe Kryetarin e Senatit	Kordinatori T.Shehu	29.10.2008.
4	Bashkrendimi i punes ndermjet Drejtorise se Shkolles dhe Qeverise.	Drejtoria dhe Qeveria e nxenesve.	
5	Dita Boterore e ujit	Drejtoria e shkolles,mesues nxenes.	07.11.2008.
6	100 - vjetori i Kongresit te Manastirit.	Mesuesit T. Shehu, A. Neziri M. Alia, S.Iseberi	10 - 13 Nentor.
7	Higjeha ne klase	Qeveria e nxenesve	
8	Bisede me veterane per festat e Nentorit.		28.11.2008.
9	Bisede me mjeken Gj.Cahani per luften kunder "Aids"-it	Qeveria e nxenesve dhe Shoqeria civile	01.12.2008.
10.	Sensibilizimi i luftes kunder dhunes.	Kordinatori dhe Qeveria e nxenesve.	12.12.2008.
11.	Mbrojtja kunder zjarrit ne shkolle.	Kordinatori dhe Qeveria e nxenesve.	
12.	Pastrimi i pergjithshem	Qeveria e nxenesve	09.02.2009.
13.	Aktivitetet me rastin e 7 - 8 Marsin	Qeveria e nxenesve ne bashkpunim me nxenesit.	7 Mars 2009.
14.	konkurs (Lulja me e bukur)	mesuesja Suela Spahiu, Drita Bajra.	
15.	Eskursion ne Kosove "Vizite ne burimin e "Drinit te Zi" dhe ne shtepine muze te "Adem Jasharit"	qeveria e nxenesve+Drejtoria+nxenesit dhe mesuesit	Muaji Prill dhe Maj
16.	Aktivitetet me rastin e "5-Majit" vizite ne varrezet e deshmorve.	Drejtoria dhe Qeveria e nxenesve.	05.05.2009
17.	Aktivitetet me rastin e 1 -Qeshorit "Festa e femijeve"	Drejtoria dhe Qeveria e nxenesve.	01.07.2009
18	Ceromonia e mbylljes se shkolles.	Drejtoria e shkolles.	13.07.2009

Sh e Ze